



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:178232

Datë: 15.02.2023

Numri i dokumentit: 03982246

**PKR.nr.1016/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda – kryetarja e trupit gjykues gjyqtarja Alltën Murseli, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qëndresa Alimehaj-Ujkani, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.N, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda PP/II.nr. 7587/17 të dt. 15.02.2018, në shqyrtimin fillestar publik me datën 08.02.2023 në prani të Prokurorit të Shtetit Besa Limani, të akuzuarit F.N, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Bahtir Troshupa ,me datë 13.02.2023 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

**F.N**, nga i ati **E.**, dhe e ëma **K.**, e gjinisë **K.**, i lindur më 02.01.1989, në Fsh. D.- Vushtrri, ku edhe jeton me vendbanim në Rr” O&Sh.B” nr. , me numër personal të letërnjoftimit “numri personal”, me profesion kuzhinier , punon në market “I.” sh.p.k në Milloshevë, i martuar, baba i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Me datë 23.11.2017, rreth orës 19:30, tek Rrethi i Flamurit në Prishtinë, në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me ligjin, gjatë bastisjes së veturës së tipit M... me targa “shifra e targave”, nga Policia e Kosovës tek i pandehuri F.N është gjetur një armë e tipit ‘Z...’ CL.7.65 mm, M..., me nr. serik ....., e tipit Kroat, një karikator në të cilin ka pasur tre fishek, për të cilët i pandehuri nuk ka poseduar leje valide nga organi kompetent.

**- me ç ‘rast ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në pajtim me nenet 4, 7, 17, 38, 40, 43, 69,70 dhe 374 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 450, 453 KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **1000€ (një mijë) euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, por jo më gjatë se tre muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të cilin dënim është i obliguar ta përmbushë në dy rata, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë pas afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20€ (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

Konform nenit 374 par. 3 të KPRK-së dhe nenit 282 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, konfiskohet: arma e tipit : "Z.... " CL.7.65 mm, M..., me nr. serik ....., e tipit Kroat, një karikator në të cilin ka pasur tre fishek.

Detyrohet i akuzuarit që në emër të shpenzimeve te procedurës penale- paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **40€ (dyzet/ €uro)** të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë me numër PP.II.nr. 7587/17 të dt. 15.02.2018 ndaj të akuzuarit F.N, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 08.02.2023 në të cilën kanë prezantuar Prokurorja e shtetit Besa Limani dhe i akuzuari dhe mbrojtësin e tij sipas autorizimit Av.Bahtir Troshupa.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar me vullnet të plotë dhe të vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, dhe ka theksuar se nuk do të përsërit më , duke kërkuar nga gjykata që të i shqiptoj një dënim më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Bahtir Troshupa në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pas analizimit, konstatimit dhe sintetizimit të tërësishëm të pretendimeve të Prokurorisë dhe të arsytetimeve të pandehurit, u vërtetua që ka poseduar armë por në fakt arma nuk është përdorë, nuk ka krijuar pasoja përveç shkeljes së normave ligjore , nga data e kryerjes së kësaj vepre i pandehuri ka rënë ndesh me ligjin edhe një herë, ka vuajtur dënim në Republikën e shtetit Gjerman, dhe përkushtimi i organeve gjermane dhe sistemi i zhvilluar penitensiar ka ndikuar në përmisimin e të pandehurit, tani është familjar, ka biznes, gjeneron me të ardhura rreth 500 Euro në muaj, kontaktet e kaluara me ligjin, jeta në burg, udhëzimet nga punëtorët social por edhe predikuesit fetar kanë arritur standardin e nevojshëm të përmisimit të pandehurit në aspektin etik dhe ligjor, e kaluara e tij duhet të konsiderojmë që të merret pozitive ne aspektin e transformimit dhe përmisimit të tij, duke lutur gjykatën të mos merret rrethanë negative në rastin e përcaktimit të sanksionit penal, propozimet nuk e obligojnë gjykatën por në interesin e të pandehurit , gjykatës i propozojmë një dënim të ulët, në lartësinë e të ardhurave të pandehurit.

Prokurorja e Shtetit dha mendimin e tij lidhur me deklarin e fajësisë nga i akuzuari, duke deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet se e njëjta është dhënë në kuptim me ligjin dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Pas deklarinimit të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësinë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, i akuzuari nuk kanë qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPPK-së. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i pandehuri F.N, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të tij përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPPK-së, e për çka gjykata gjeti se i njëjti në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPPK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me veprën e kryer, është hera e pare që kanë renë ndesh me ligjin, është mbajtës i familjes, ndërsa rrethana posaçërisht rënduese nuk gjeti sa i përket të kaluarës kriminale ndaj të akuzuarit gjykata nuk pati të dhëna andaj të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj vepre penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPPK-së.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një vepër penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim për të akuzuarit është marrë në kuptim të nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e armës – së tipit ‘Z....’ CL.7.65 mm, M..., me nr. serik ....., e tipit Kroat, një karikator në të cilin ka pasur tre fishek gjykata e ka marr konform neneve 374 par.3 të KPRK-së dhe nenit 282 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**  
**- Departamenti i Krimeve të Rënda -**  
**PKR.nr 1016/20 të dt.13.02.2023**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
Qëndresa Alimehaj- Ujkani

**Kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja**  
Alltën Murseli

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet  
Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e  
pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në  
Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.